



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201700387/7

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:** Rekomandim për marrjen e masave për mundësimin e vizitës së mjekut psikiatër në ambientet e familjes C.C., si dhe hartimin e Planit të Monitorimit për vajzën e mitur.

**Drejtuar:** **Z. Ilia STEFO**  
Kryetari i Bashkisë Kolonjë

**Kolonjë**

I nderuar z. Stefo,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1944, datë 03.07.2017, ku shpjegoni ecurinë e çështjes së familjes Cinari, ju sqarojmë si më poshtë:

në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"*:

### REKOMANDOJMË

1. Të merren masa për të mundësuar vizitën e mjekut psikiatër në ambientet e shtëpisë së familjes Cinari, për të vizituar djalin e kësaj familje.
2. Në zbatim të Udhëzimit Nr. 10, Datë 25.2.2015 "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës" të Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, Ministrisë të Shëndetësisë dhe ministri i Punëve të Brendshme, të merren masa nga ana juaj për Hartimin e Planit të Monitorimit për realizimin e vizitës së vajzës në strukturat e specializuara në qytetin e Tiranës, sipas rekomandimit të mjekut të Institutit të Shëndetit Mendor Korçë.
3. Të merren masa që një kopje të Planit të Monitorimit të na e dërgoni ne si institucion së bashku së bashku me një informacion të plotë mbi vizitën shëndetësore të vajzës në Tiranë ku të keni të bashkëlidhur rekomandimet e mjekut specialist për rastin në fjalë.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar ku përcaktohet se: *"Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një"*

*rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”.*

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**